



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11.5.2023

Nr: 485

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË RADIO TELEVISIONIT SHQIPTAR, TV 6+1 VLORA, NTV TELEVISION, SCAN TV DHE GAZETËS ONLINE "SI", PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot në datën 11.5.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat e:

- KËRKUES:** Radio Televizioni Shqiptar me adresë Rruga "Ismail Qemali", Tiranë dhe me përfaqësues z. Enkelejdi Joti;
- Televizioni "6+1 Vlora" me adresë "Rruga e Paqes", Lagja "Kushtrimi" dhe me përfaqësues z. Albert Deliaj;
- Televizioni "SCAN" me adresë Rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë dhe me përfaqësues zj. Dorina Sela;
- Televizioni "NTV" me adresë Autostrada Tiranë - Durrës, me përfaqësues z. Andi Bora;
- Gazeta online "Si" me përfaqësues z. Adrian Proko;
- OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi i përfaqësuesve të Medias për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023
- BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.1.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave".

Data: 11.5.2023 Nr: 485
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin e kërkesave të Radio Televizionit Shqiptar, TV 6+1 Vlora, NTV Televizion, Scan TV dhe gazetës Online "Si", për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

V Ë R E J:

Radio Televizioni Shqiptar i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 164 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër) gazetarë dhe operatorë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur nuk respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Radio Televizioni Shqiptar është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Televizioni “6+1 Vlorë” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 6 (gjashtë) gazetarë dhe operatorë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur nuk respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni “6+1 Vlorë” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Televizioni “SCAN” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 13 (trembëdhjetë) gazetarë dhe operatorë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur nuk respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni “SCAN” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Televizioni “NTV” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 2 (dy) gazetarë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur nuk respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni “NTV” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Gazeta online “Si” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 7 (shtatë) gazetarë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur nuk respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Gazeta online “Si” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Kërkesat e paraqitura nuk janë dorëzuar brenda afatit procedural të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Subjektet kërkuese gëzojnë të drejtën të caktojnë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor dhe përmbushin kushtin ligjor.

Afatet në procedurën administrative janë me rëndësi të veçantë për krijimin ose humbjen e ndonjë të drejte të palës. Afati i përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor i cili përcakton se kërkesat e vëzhguesve shqiptarë për akreditim i paraqiten Komisionit Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se data 2.5.2023, paraqet një interval të caktuar kohor, brenda të cilit duhet të kryhet veprimi në procedurën administrative. Afati procedural në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor, në kuptim të nenit 53, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, nuk përbën afat të karakterit prekluziv, mosrespektimi i të cilit do të sillte humbjen e së drejtës subjektive të palës.

Data: 11.5.2023 Nr: 485
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të Radio Televizionit Shqiptar, TV 6+1 Vlorë, NTV Televizion, Scan TV dhe gazetës Online “Si”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Në Kodin Zgjedhor është vendosur një afat i logjikshëm për palët kërkuese nga njëra anë për realizimin e së drejtës së tyre të ligjshme për të pasur vëzhgues në zgjedhje, dhe nga ana tjetër, për vetë administratën e KQZ-së, për të kryer veprimet procedural përkatëse. Kërkesa e paraqitur për realizimin e së drejtës së palës kërkuese dhe mosrespektimi i afatit procedural nuk sjell humbjen e të drejtën për të kryer veprimin procedural, të cilin është dashur ta kryejë brenda afatit të caktuar.

Në çdo rast, vendosja e këtij afati procedural konsideron garantimin e sigurisë juridike dhe standardeve të rëndësishme për një proces të rregullt zgjedhor. Afatet në këtë rast nuk janë indikative, në kushtet kur implikojnë cënim të standardit zgjedhor. Pika 2, e nenit 6, të Kodit Zgjedhor parashikon se, organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe të medias kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues në zgjedhje. Në këtë kuptim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve arrin në konkluzionin se afati i parashikuar në Kodin Zgjedhor nuk është afat prekluziv, që të përbënte kusht për refuzimin e kërkesës dhe moszbatimin e afatit tërësor të akreditimit të vëzhguesve përpara datës së zgjedhjeve. Interpretimi ndryshe i kësaj dispozite, do t'i mohonte kërkuarit të drejtën për të caktuar vëzhgues.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 19, datë 27.1.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

V E N D O S :

1. Akreditimin e 164 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër) gazetarëve dhe operatorëve të Radio Televizionit Shqiptar, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin e 6 (gjashtë) gazetarëve dhe operatorëve të Televizionit “6+1 Vlora”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Akreditimin e 13 (trembëdhjetë) gazetarëve dhe operatorëve të Televizionit “SCAN”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin e 2 (dy) gazetarëve të Televizionit “NTV”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Akreditimin e 7 (shtatë) gazetarëve të Gazetës online “Si ”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI